LIGJ
Nr. 96/2015

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BASHKIMIT EUROPIAN PËR PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN "EVROPA PËR QYTETARËT"

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin "Evropa për qytetarët", sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesëve përbërëse të tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 17.9.2015

Shpallur me dekretin nr. 9233, datë 25.9.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

Komisioni Evropian Bruksel, më 1.8.2014
C(2014) 5366, përfundimtar

ANEKSI 1
ANEKS I VENDIMIT TË KOMISIONIT PËR MIRATIMIN NË EMËR TË BASHKIMIT EVROPIAN, TË NJË MARRËVESHJEJE MBI PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN "EVROPA PËR QYTETARËT"

ANEKS
MARRËVESHJEJE
NDËRMJET BASHKIMIT EVROPIAN DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, MBI PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN "EVROPA PËR QYTETARËT"

Komisioni Evropian, në vijim i referuar si "Komisioni" në emër të Bashkimit Evropian, nga njëra anë, dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në vijim i referuar si "Shqipëria", nga ana tjetër,

duke marrë në konsideratë se:

1. Një Marrëveshje Kuadër është nënshkruar më 22 nëntor 2004, ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë[1], e cila vendos parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programet e Bashkimit. Neni 5 i Marrëveshjes Kuadër parashikon se afatet dhe kushtet specifike, duke përfshirë kontributin financiar në lidhje me pjesëmarrjen e Shqipërisë në çdo program të veçantë, do të vendoset nga Komisioni dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë;

[1] OJL 192, 22.7.2005, f. 2

2. Programi "Evropa për qytetarët" është krijuar nga Rregullorja e Këshillit (BE) nr. 390/2014, e datës 14 prill 2014;[2]

3. Subjektet e themeluara në Shqipëri duhet të kenë të drejtën të marrin pjesë në aktivitetet e vazhdueshme, të cilat duhet të fillojnë para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Si pasojë, kostot e kryera për këto aktivitete, zbatimi i të cilave fillon më 2014-n, mund të konsiderohen të pranueshme sipas të njëjtave kushteve si ato që aplikohen për kostot e kryera nga subjekte të themeluara në Shtetet Anëtare, me kusht që kjo Marrëveshje hyn në fuqi para përfundimit të veprimit në fjalë,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Programi

Shqipëria do të marrë pjesë në Programin "Evropa për qytetarët" (në vijim i referuar si "Programi"), në përputhje me kushtet e parashtruara në Marrëveshjen Kuadër, të datës 22 nëntor 2004, ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, mbi parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programet e Komunitetit, dhe sipas afateve dhe kushteve të përmendura në nenet 2–5 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

Afatet dhe kushtet e pjesëmarrjes në Program

Pjesëmarrja e Shqipërisë në aktivitetet e Programit duhet të jetë në përputhje me objektivat, kriteret, procedurat dhe afatet e përcaktuar në Rregulloren e Këshillit (BE) nr. 390/2014.

Afatet dhe kushtet e zbatueshme për dorëzimin, vlerësimin dhe përzgjedhjen e aplikimeve dhe për zbatimin e veprimeve nga subjekte të pranueshme nga Shqipëria duhet të jenë të njëjta ai ato që janë zbatuar për subjektet e pranueshme nga Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian.

Shqipëria duhet të vendosë strukturat dhe mekanizmat e duhur në nivel kombëtar dhe duhet të miratojë të gjitha masat e tjera të nevojshme për koordinimin kombëtar dhe organizimin e aktiviteteve, për të zbatuar Programin në përputhje me dispozitat përkatëse në rregulloren që krijon këtë Program. Në veçanti, Shqipëria merr përsipër të krijojë një Pikë Kontakti "Evropa për qytetarët", në përputhje me udhëzimin e parashikuar nga Komisioni.

Për të marrë pjesë në Program, Shqipëria do të paguajë çdo vit një kontribut financiar për Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Evropian në përputhje me nenin 3 më poshtë.

Kontributi financiar i Shqipërisë në lidhje me pjesëmarrjen e saj dhe zbatimin e Programit do t'i shtohet shumës së rezervuar çdo vit në Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Evropian për ndarje buxhetore për të përmbushur detyrimet financiare që rrjedhin nga forma të ndryshme masash të nevojshme për zbatimin, menaxhimin dhe funksionimin e Programit.

Një nga gjuhët zyrtare të Bashkimit Evropian do të përdoret për procedurat që lidhen me kërkesat, kontratat dhe raportet, si edhe për aspekte të tjera administrative të Programit.

Neni 3

Kontributi financiar

Rregullat që drejtojnë kontributin financiar të Shqipërisë janë përcaktuar në aneksin I.

Neni 4

Raportimi dhe vlerësimi

Pa cenuar përgjegjësitë e Komisionit dhe të Gjykatës Evropiane të Auditëve, në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e Programit, pjesëmarrja e Shqipërisë në Program do të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme mbi një bazë partneriteti, duke përfshirë Komisionin dhe Shqipërinë. Shqipëria do t'i paraqesë Komisionit raportet përkatëse dhe do të marrë pjesë në aktivitete të

[2] OJL 115, 17.4.2014, f. 3

tjera specifike të parashikuara nga Bashkimi Evropian në atë kontekst.

Rregullat që lidhen me kontrollin financiar, rivendosjen dhe masat e tjera kundër mashtrimit janë parashtruar në aneksin II.

Neni 5

Dispozitat përfundimtare

Kjo Marrëveshje do të zbatohet për kohëzgjatjen e Programit. Megjithatë, nëse Bashkimi Evropian do të vendosë të shtyjë afatin pa ndonjë ndryshim thelbësor brenda Programit, afati i kësaj Marrëveshjeje do të zgjatet në mënyrë automatike nëse asnjë palë nuk e denoncon atë brenda një muaji pas hyrjes në fuqi të një akti ligjor, i cili zgjat Programin.

Bashkimi Evropian dhe Shqipëria mund t'i përfundojnë aktivitetet sipas kësaj Marrëveshjeje në çdo kohë pas njoftimit me shkrim dymbëdhjetë muaj para. Projektet dhe aktivitetet në progres në kohën e përfundimit do të vazhdojnë deri në plotësimin e tyre sipas kushteve të vendosura në këtë Marrëveshje, si edhe marrëveshjeve kontraktuale që zbatohen për këto projektet dhe aktivitete dhe dispozitat e anekseve.

Anekset do të jenë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me shkrim me pëlqimin e ndërsjellë të palëve.

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e njoftimit me shkrim me anë të të cilit Shqipëria njofton Komisionin nëpërmjet kanaleve diplomatike mbi përmbushjen e kërkesave ligjore të brendshme për hyrjen e saj në fuqi.

Hartuar në ……., datë……
Për Këshillin e Ministrave të Republikës së
Shqipërisë

Erion Veliaj
Ministër i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë i
Republikës së Shqipërisë

Hartuar në ……., datë……
Për Komisionin, në emër të Bashkimit Evropian

Gregory Paulger
Drejtor i Përgjithshëm
Drejtoria e Përgjithshme e Komunikimeve

ANEKSI I

RREGULLAT QË DREJTOJNË KONTRIBUTIN FINANCIAR TË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN "EVROPA PËR QYTETARËT"

Kontributi financiar vjetor që duhet të paguhet nga Shqipëria në Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Evropian për të marrë pjesë në Programin "Evropa për qytetarët" do të jetë 20 000 euro.

Shpenzimet e udhëtimit dhe shpenzimet e jetesës që kryhen nga përfaqësuesit dhe ekspertët e Shqipërisë për qëllimet e pjesëmarrjes si vëzhgues në punën e Komitetit të përmendur në nenin 9 të Rregullores së Këshillit (BE) nr. 390/2014 ose mbledhje të tjera në lidhje me zbatimin e Programit duhet të rimbursohen nga Komisioni mbi të njëjtën bazë dhe në përputhje me procedurat aktualisht në fuqi për përfaqësuesit e Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian.

Shuma maksimale e mbështetjes financiare që do të ndahet nga Programi për aktivitetet e Pikës së Kontaktit "Evropa për qytetarët" do të jetë 10 000 euro.

Rregullorja (BE, Euratom) nr. 966/2012, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 25 tetor 2012, mbi rregullat financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Evropian, do të zbatohet për menaxhimin e kontributit të Shqipërisë.

Kur kjo Marrëveshje të hyjë në fuqi dhe në fillim të çdo viti buxhetor pasues, Komisioni do t'i dërgojë Shqipërisë një ftesë për fonde që korrespondon me kontributin e saj të shpenzimeve që mbulohen nga kjo Marrëveshje.

Ky kontribut paguhet në euro në një llogari bankare të Komisionit të shprehur në euro.

Shqipëria do të paguajë kontributin e saj për shpenzimet vjetore, jo më vonë se tre muaj pas datës së ftesës, me kusht që ftesa për fondet të dërgohet nga Komisioni para datës 1 mars ose maksimumi një muaj pas ftesës për fonde nëse dërgohet më vonë. Çdo vonesë në pagesën e kontributit do të shkaktojë pagesën e interesit të munguar nga Shqipëria për shumën e papaguar nga data e duhur. Norma e interesit do të jetë norma e zbatuar nga Banka Qendrore Evropiane për operacionet e saj kryesore të rifinancimit, siç publikohet në serinë "C" të Fletores Zyrtare të Bashkimit Evropian, në fuqi në ditën e parë kalendarike të muajve në të cilët bie afati, rritur me 3.5 pikë për qind. Nëse vonesa në pagesën e kontributit është e tillë që mund të rrezikojë seriozisht zbatimin dhe menaxhimin e Programit dhe në mungesë të pagesës 20 ditë pune pas dërgimit të letrës formale të kujtesës nga Komisioni për Shqipërinë, pjesëmarrja e Shqipërisë në Program për vitin përkatës do të pezullohet.

ANEKSI II
KONTROLLI FINANCIAR, RIMËKËMBJA DHE MASA TË TJERA KUNDËR MASHTRIMIT

I. Kontrollet dhe masat kundër mashtrimit nga Bashkimi

1. Në pajtim me rregulloren financiare të zbatueshme për Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Evropian, si dhe me rregullat e tjera të përmendura në këtë Marrëveshje, kontratat dhe marrëveshjet e grantit, të lidhura me kontraktorët dhe përfituesit e Programit, themeluar në Shqipëri, parashikojnë auditime financiare dhe të tjera që kryhen në çdo kohë gjatë zbatimit të kontratës ose marrëveshjes së grantit dhe për një periudhë prej 5 vjetësh, duke filluar nga data e pagesës së bilancit, me përjashtim për grantet e një shume të barabartë ose më të vogël se 60 000 euro, për të cilat kjo periudhë do të kufizohet në 3 vjet. Auditimet financiare, apo të tjera, do të kryhen në ambientet e kontraktuesve dhe nënkontraktuesve të tyre dhe në ambientet e përfituesve dhe kontraktuesve dhe nënkontraktuesve të tyre nga agjentët e Komisionit ose nga persona të tjerë të autorizuar nga Komisioni.

2. Agjentët e Komisionit dhe personat e tjerë të autorizuar nga Komisioni do të kenë akses të duhur në faqet, punimet dhe dokumentet dhe në të gjithë informacionin e kërkuar, në mënyrë që të kryejnë autditime të tilla, duke përfshirë edhe në formë elektronike. Kjo e drejtë aksesi do të parashikohet shprehimisht në kontratat dhe marrëveshjet e granteve, të lidhura për të zbatuar dokumentet ligjore të përmendura në këtë Marrëveshje. Gjykata Evropiane e Auditëve ka të njëjtat të drejta si Komisioni.

3. Brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje, Komisioni/OLAF-i (Zyra Evropiane kundër Mashtrimit) autorizohet të kryejë kontrolle dhe inspektime në vend në territorin e Shqipërisë, në përputhje me dispozitat procedurale të Rregullores së Këshillit (Euratom, EC) nr. 2185/96, të 11 nëntorit 1996.[3]

Këto kontrolle dhe inspektime përgatiten dhe zhvillohen në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet kompetente të Shqipërisë, të caktuara nga autoritetet e Shqipërisë, të cilat do të njoftohen në kohën e duhur për objektin, qëllimin dhe bazën ligjore të kontrolleve dhe inspektimeve, në mënyrë që të mund të ofrojnë të gjithë ndihmën e nevojshme.

Nëse autoritetet e Shqipërisë në fjalë dëshirojnë, kontrollet dhe inspektimet në vend mund të kryhen bashkërisht me ato autoritete.

Kur pjesëmarrësit në Program i rezistojnë një kontrolli ose inspektimi në vend, autoritetet e Shqipërisë, duke vepruar në pajtim me rregullat e brendshme, u japin inspektorëve të Komisionit /OLAF-it atë ndihmë që ata kanë nevojë për t'i lejuar të kryejnë detyrat e tyre në kryerjen e një kontrolli ose inspektimi në vend.

[3] OJ L 292, 15.11.1996, f. 2

Komisioni/OLAF-i raporton sa më shpejt të jetë e mundur tek autoritetet e Shqipërisë çdo fakt ose dyshim në lidhje me një parregullsi që ka hasur gjatë kryerjes së kontrollit ose inspektimit në terren. Në çdo rast, Komisionit/OLAF-it do t'i kërkohet të informojë autoritetin e sipërpërmendur për rezultatin e këtyre kontrolleve dhe inspektimeve.

II. Informacioni dhe konsultimi

1. Për qëllimet e zbatimit të duhur të këtij aneksi, autoritetet kompetente të Shqipërisë dhe autoritetet e Bashkimit Evropian do të shkëmbejnë rregullisht informacion dhe do të zhvillojnë konsultime me kërkesë të njërës prej palëve.

2. Autoritetet kompetente të Shqipërisë do të informojnë Komisionin, pa vonesë, mbi çdo fakt ose dyshim, i cili është njoftuar në lidhje me një parregullsi, për sa i përket lidhjes me përfundimin dhe zbatimin e kontratave dhe marrëveshjeve të granteve, të lidhura në zbatim të dokumenteve ligjore të përmendura në këtë Marrëveshje.

III. Masat administrative dhe gjobat

Pa cenuar zbatimin e ligjit penal të Shqipërisë, masat administrative dhe gjobat mund të vendosen nga Komisioni në pajtim me rregulloren financiare të zbatueshme për Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Evropian.

IV. Rivendosja

Vendimet e marra nga Komisioni, brenda objektit të kësaj Marrëveshjeje, e cila vendos një detyrim financiar mbi personat e ndryshëm nga shtetet do të jenë të ekzekutueshme në Shqipëri. Ekzekutimi do të drejtohet nga rregullat e procedurës civile në fuqi, në shtetin në territorin e të cilit është kryer. Urdhri i ekzekutimit i bashkëlidhet vendimit, pa formalitet tjetër, përveç verifikimit të autenticitetit të vendimit, nga autoriteti kombëtar, i cili caktohet nga qeveria e Shqipërisë për këtë qëllim dhe do ta bëjë të njohur për Komisionin. Kur këto formalitete kanë përfunduar me kërkesën nga Komisioni, ky i fundit mund të vazhdojë me ekzekutimin në pajtim me ligjin kombëtar, duke e sjellë çështjen drejtpërdrejt para autoritetit kompetent. Ligjshmëria e vendimit të Komisionit do t'i nënshtrohet kontrollit të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian.

Gjykimet e dhëna nga Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian në bazë të një klauzole arbitrazhi në një kontratë dhe një marrëveshje granti në kuadër të kësaj Marrëveshjeje do të jenë të zbatueshme në të njëjtat kushte.

V. Komunikimi i drejtpërdrejtë

Komisioni do të komunikojë drejtpërdrejt me pjesëmarrësit në Programin "Evropa për qytetarët", të themeluar në Shqipëri. Ata mund t'i paraqesin drejtpërdrejt Komisionit të gjithë informacionin përkatës dhe dokumentacionin të cilin janë të detyruar të paraqesin në bazë të dokumenteve të përmendura në këtë Marrëveshje, si dhe kontratave dhe marrëveshjeve të grantit të lidhura për zbatimin e tyre.